




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Rregullore Nr. 01/2023

22.03.2023

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, mbështetur në nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1, 1.9, 1.10, 1.14, 28, paragrafi 4, 29, si dhe nen 71, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenit 12. par. 1.3, të Statutit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 04-V- 312 data 02. 03. 2012, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me dt. 22.03.2023 miraton këtë:

RREGULLORE PËR PROCEDURAT HETIMORE TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat e procedurës që ndjekë Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të neneve 5, 8, 11, si dhe për kryerjen e studimeve të tregjeve, sipas Ligjit Nr.08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.
2. Kjo rregullore është pjesërisht e përafruar me aktet relevante ligjore të Bashkimit Evropian.

Neni 2

Përkufizimet

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - 1.1. "Ligji" do të kuptojmë Ligjin Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës;
 - 1.2. "Autoriteti i Konkurrencës", që më poshtë do të quhet Autoriteti, është struktura e ngarkuar me kontrollin e zbatimit të këtij ligji;

- 1.3. "Komision i Konkurrencës", që më poshtë do të quhet Komisioni, është struktura vendimmarre e Autoritetit të Konkurrencës;
- 1.4. "Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës", që më poshtë do të quhet Sekretariati është struktura që kryen procedurat hetimore të Autoritetit;
- 1.5. "Drejtori i Përgjithshëm" drejton Sekretariatin dhe përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Sekretariatit;
- 1.6. "Grupi i Punës", është grupi i nëpunësve të Sekretariatit, të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm për të kryer procedurat hetimore;
- 1.7. "Dokument" do tëkuuptojmë çdo grafikë, dokument i shkruar, shkresat, e-mail, fotografimi, elektromagnetike, digitale, ose çdo lloj tjetër përfaqësimi të dokumenteve. Këtu përfshihen edhe dokumentet e brendshme dhe jozyrtare, të cilat janë hartuar dhe janë përdorur për qëllime të veprimtarive të ndërmarrjes, pavarësisht nga niveli i përgjegjësisë së autorit të dokumentit, si përfaqësues i ndërmarrjes, si dhe çdo dokument tjetër që është hartuar ose është ruajtur në një kompjuter.

KAPITULLI II

PËRGATITJET DHE FILLIMI I PROCEDURËS HETIMORE

Neni 3

Zhvillimi i procedurës hetimore

1. Autoriteti i Konkurrencës kryen hetimet e tregut me iniciativën e vet. Ankesat e arsyeshme, sugjerimet dhe pikëpamjet e palëve të interesuara dhe të publikut mund të përbëjnë bazën për fillimin e procedurës hetimore të tregut, por nuk u jep ankuesve një pozicion të pavarur përfshirjeje.
2. Në ushtrimin e funksioneve që janë në kompetencën e Autoritetit, nëse me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk është e rregulluar ndryshe, aplikohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa paragjykim ndaj parimeve të efikasitetit dhe efektivitetit në lidhje me rregullat e BE-së për konkurrencën.
3. Gjatë vlerësimit, nëse duhet të fillohet me procedure hetimore, rrethanat e mëposhtme merren për bazë:
 - 3.1. Nëse ekziston një dyshim i arsyetuar për rrethanat, ose sjelljen që parandalon, kufizon në çfarëdo forme ose ndikon konkurrencën në dëm të interesit publik;
 - 3.2. Rëndësia e tregut në fjalë për konsumatorët dhe sektorin ekonomik;
 - 3.3. Indikacionet dhe rastet e mëparshme që kanë të bëjnë me kufizimet e konkurrencës në treg;

- 3.4. Efektet e mundshme direkte dhe indirekte të kufizimeve të konkurrencës tek konsumatorët;
 - 3.5. Kostoja e vlerësuar e hetimit;
 - 3.6. Përcaktimi i prioriteteve të Autoritetit të Konkurrencës; dhe
 - 3.7. Financimi i alokuar për hetimet e tregut.
3. Sekretariati është i autorizuar që të kryejë shqyrtimin paraprak dhe zhvillimin e procedurës hetimore, të cilat janë në kompetencën e Autoritetit, ndërsa vendimi do të merret nga Komisioni në përputhje me dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 si dhe neni 55 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.
4. Qëllimi i shqyrtimit paraprak është evidentimi nëse ka ose jo shenja të pengimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg, të cilat mund të shërbejnë si shkaqe për hapjen e hetimit të thelluar me konkluzion përfillimin e procedurës nga Komisioni, sipas nenit 37 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Neni 4

Orari i hetimeve, agjenda dhe plani i hetimit

1. Sekretariati përgatit një plan për organizimin e hetimit të tregut si bazë për manjen e vendimit për zhvillimin e procedurës përfundimtare.
2. Plani duhet të adresojë të paktën sa vijon:
 - 2.1. Tregjet në të cilat do të drejtohet hetimi;
 - 2.2. Kush operon në tregun në fjalë;
 - 2.3. Ato rrëthana ose sjellje që Autoriteti i Konkurrencës i konsideron të nevojshme përfundimtare;
 - 2.4. Organizimi i mbledhjes së informacionit në fillim;
 - 2.5. Afati kohor përfundimtare, duke përfshirë kohën kur duhet të përfundojë mbledhja e informacionit dhe kur duhet të paraqitet raporti i vlerësimit fillostar.

Neni 5

Vendimmarrja, menaxhimi i projektit dhe konsultimi

1. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës diskuton planin e hetimit (shqyrtimin paraprak) sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje dhe e miraton atë. Konfirmimi i planit të hetimit paralajmëron fillimin e procedurës hetimore të tregut.
2. Në rastet e veçanta pas marrjes së propozimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës mund të caktojë një komitet konsultativ

për hetim tregu. Rol i komitetit konsultativ është të japë këshilla dhe asistencë profesionale në lidhje me hetimet e tregut, të cilat kryhen nga Autoriteti i Konkurrencës. Komiteti konsultativ përbëhet nga të paktën një anëtarë i jashtëm.

3. Pjesëmarrësit e komitetit konsultativ u nënshtronen të gjitha përgjegjësive të punës sipas Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe ligjit mbi zyrtarët publikë, duke përfshirë konfidencialitetin. Në konfirmim të saj, ata duhet të nënshkruajnë dhe dorëzojnë një deklaratë nën betim.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës i paraqet Komisionit të AKRK-së një plan hetimi dhe mban përgjegjësi dhe menaxhon zbatimin e hetimeve të tregut në aspekte të tjera. Drejtori i Përgjithshëm është palë përgjegjëse për hetimet e tregut në raport, apo marrëdhënie me palët e treta.

KAPITULLI III

PROCEDURA

Neni 6

Njoftimi për fillimin e një rasti dhe vonesat

1. Palët kundër të cilave merret konkluzioni për hapje të procedurës do të njoftohen për hetimin. E njëjtë gjë vlen edhe për palët kundër të cilave hetimi mund të drejtohet në një datë të mëvonshme. Konkluzioni për fillimin e një procedure do të shpallet edhe me një njoftim për shtyp në ueb faqen e Autoritetit të Konkurrencës. Në përgjithësi, njoftimi duhet të tregojë pikat e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

2. Autoriteti i Konkurrencës fillon procedurën sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesë, propozim, kundërshtim ose çdo paraqitje tjetër me shkrim, e cila mund të paraqitet nga çdo person fizik ose juridik, shoqatë profesionale, shoqatë e ndërmarrjeve ose ekonomike me interes, shoqatë e konsumatorëve, Qeveria e Republikës së Kosovës, organet e administratës publike qendrore dhe lokale.

3. Në rastet kur iniciativa për fillimin e procedimit administrativ merret nga palët e interesuara, kërkesa duhet të bëhet me shkrim, përcaktohet data nga personi që kërkon veprimin e Autoritetit ose nga përfaqësuesi ligjor i palës, dhe përmban:

- 3.1. Emërtimin dhe selinë e personit juridik, emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e personit fizik që ka paraqitur kërkesën;
- 3.2. Emërtimin e organit të cilit i drejtohet;
- 3.3. Data e postimit apo e dorëzimit;

- 3.4. Emërtimin dhe selinë e personit juridik, emër/mbiemër dhe vendqëndrimi i personit fizik që ka paraqitur shkresën;
 - 3.5. Të dhënat e qarta me të cilat kuptohet se kundër cilit është paraqitur iniciativa;
 - 3.6. Një indikacion në lidhje me rrëthanat dhe kompetencat e Autoritetit në kuadër të të cilët kërkohet veprimi dhe
 - 3.7. Autorizimin, dokumentet dhe fakte tjera që disponon paraqitësi i kërkesës, të cilat plotësojnë paraqitjen nga nënparagrafi 3.4 të këtij neni.
5. Nëse parashikohet se do të ketë vonesa nga orari fillestar i hetimit, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, palët duhet të njoftohen për ndryshimet në orar. E njëjtë gjë do të veprohet edhe me njoftimin për shtyp në ueb faqen e Autoritetit të Konkurrencës.

Neni 7

Regjistrimi i kërkesës për fillimin e procedurës

1. Pavarësisht nga mënyra e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedurës administrative, Autoriteti i regjistron ato në një regjistër të posaçëm në pajtim me dispozitat në fuqi e që përmban:
 - 1.1. Numrin e kërkesës;
 - 1.2. Datën e dorëzimit;
 - 1.3. Objektin e Kërkesës;
 - 1.4. Numrin dhe emërtimin e dokumenteve të bashkangjitura me kërkesën; dhe
 - 1.5. Emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e kërkuesit.
2. Kërkesat regjistrohen sipas radhës së dorëzimit.

Neni 8

Vërtetimi që i lëshohet palës së interesuar

1. Autoriteti u lëshon dëshmi personave të interesuar që paraqesin kërkesën bashkë me listën e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës.
2. Të njëjta dispozita vlejnë edhe për kërkesat për rishqyrtim, mendime profesionale, përgjigje apo çdo dokument tjetër shkresor.

Neni 9

Verifikimi paraprak, para fillimit të procedurës

1. Përveç verifikimit të kompetencës, e cila bëhet nga Autoriteti, menjëherë pas pranimit të kërkesës Autoriteti bën, gjithashtu edhe verifikimet e mëposhtme:
 - 1.1. Nëse të drejtat, apo interesat e kërkuar nga personat e interesuar janë parashkuar;
 - 1.2. Legjitimimi i personit fizik dhe juridik, i cili e ka dorëzuar kërkesën për fillimin e procedurës;
 - 1.3. Afatet e parashikuara nga ligji për dorëzimin e kërkesës për fillimin e procedurës;
 - 1.4. Nëse kërkesa e një personi fizik, apo juridik mund të shqyrtohet bashkë me kërkesat e personave të tjera fizik apo juridik.
2. Kërkesa e një personi fizik dhe juridik për fillimin e procedimit administrativ mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e personave të tjera, në qoftë se ato bazohen në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.
3. Vendimi i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për të shqyrtuar njëkohësisht disa kërkesa mund të kundërshtohet nga palët në procedim.

Neni 10

Fillimi i procedurës hetimore

1. Procedura konsiderohet e filluar ditën kur është marrë Konkluzioni lidhur me fillimin e procedurës.
2. Procedura hetimore zhvillohet nga Autoriteti, ose zyrtari i Autoritetit me autorizim nga Komisioni.
3. Inspektorët hetues të Autoritetit (grupi i punës) kërkojnë dhe njihen me të gjitha faktet në procedurë që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, duke përdorur të gjitha format dhe metodat e lejuara me ligj.
4. Gjatë fazës së hetimit Autoriteti mund të kërkojë informacione dhe dokumente, analiza statistikore dhe ekonomike apo edhe të konsultohet me ekspertë të lëmive të caktuara, të zhvillojnë intervista, të kryejnë inspektime të paparalajmëruara.
5. Për faktet që janë të njoitura publikisht nuk nevojitet verifikimi.

Neni 11

Rregullat e procedurës

1. Palët ndaj të cilave drejtohet hetimi dhe që mund t'i nënshtrohen masave të parapara sipas nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës gëzojnë të drejtat e parashikuara në ligjin e Procedurës Administrative dhe ato të parapara me legjislacionin në fuqi të Autoritetit të Konkurrencës.

2. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Administrative dhe ato të parapara me legjislacionin në fuqi të Autoritetit të Konkurrencës zbatohen sipas rastit të përfshirë në hetimin e tregut nga Autoriteti i Konkurrencës.

Neni 12

Vlerësimi fillestar dhe konstatimi i fakteve

1. Pas përfundimit të mbledhjes së informacionit dhe vlerësimit të të dhënave, një projekt-rezultat i hetimit të tregut do të përpilohet një raport i veçantë vlerësimi fillestar. Raporti i vlerësimit fillestar do t'u dërgohet palëve kundër të cilave është drejtuar dhe atyre do t'u jepet një afat i arsyeshëm për t'i kthyer komentet e tyre me shkrim. Raporti apo pjesët e raportit, të cilat nuk paraqesin informacion konfidencial, do të publikohet në ueb faqen e Autoritetit, si rregull, publikohen edhe pikëpamjet e atyre kundër të cilëve janë drejtuar rezultatet e komentet.
2. Pas publikimit të raportit fillestar të vlerësimit, Autoriteti i Konkurrencës do të organizojë një takim të hapur (seanca dëgjimore) ku palët e interesuara dhe të tjerët do të kenë mundësinë të paraqesin pikëpamjet e tyre për raportin. Organizimi i takimit do të njoftohet paraprakisht.
3. Nëse Autoriteti i Konkurrencës është i mendimit se mund të merret një vendim i rëndë në vazhdën e një hetimi tregu, duke përfshirë masat për të ndryshuar sjelljen dhe organizimin e shoqërive, një deklaratë kundërshtimesh do të lëshohet në lidhje me raportin e vlerësimit fillestar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KAPITULLI IV

PËRFUNDIMI I HETIMEVE

Neni 13

Përfundimi i hetimeve

1. Pas përfundimit të përpilimit të të dhënave dhe procedurave, Autoriteti i Konkurrencës merr vendim për mënyrën se si do të përfundojë hetimi i tregut. Zgjidhja mund të përfshijë një ose më shumë nga zgjidhjet e mëposhtme:

- 1.1. Vendim ku përdoren autorizimet e nenit 47 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, për ndryshimin e sjelljes dhe/ose organizimit të shoqërive;
- 1.2. Vendim ku autorizimet e nenit 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës përdoren kundër praktikave kufizuese konkuruese të autoriteteve publike;
- 1.3. Shqipton gjobë në pajtim me nenin 26, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës;

- 1.4. Hetim i posaçëm ka nisur për shkelje të mundshme të rregullave të ndalimit të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, apo udhëzimeve në vendimet e Autoritetit të Konkurrencës.
- 1.5. Nëse rezultatet e hetimit nuk çojnë në një ndërhyrje të detyrueshme, ato deklarohen në një raport që publikohet. E njëta gjë vlen nëse një pjesë e një hetimi nuk çon në një ndërhyrje detyruese. Në raste të tilla, Autoriteti i Konkurrencës mund të nxjerrë një opinion dhe rekomandime në lidhje me thelbin e raportit.

Neni 14

Rrethanat rënduese me rastin e shqiptimit të gjobës

Në përcaktimin e gjobës nga paragrafi 1.3 i nenit 13 të kësaj rregulloreje, Autoriteti ka parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Neni 15

Mbrojtja gjyqësore

Kundër akteve të Autoritetit pala mund të iniciojë me konflikt administrativ në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 66 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Neni 16

Roli i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës

1. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës diskuton rezultatet e hetimeve të tregut që i paraqiten, përmiratim ose refuzim, vendime mbi bazën e hetimeve që përfshijnë ndërhyrje sipas nenit 55 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, ose dispozitave të tjera të ligjit.
2. Një hetim, ose një pjesë e tij, që çon në një ndërhyrje detyruese mbylljet me vendim nga ana e Autoritetit të Konkurrencës në përpunim me dispozitat e legjisacionit në fuqi.
3. Hetimet e tregut, procedurat dhe vendimet në aspekte të tjera rregullohen nga Rregullorja nr. 03/2018 për Rregulloren e Punës së Autoritetit të Konkurrencës dhe Rregulloren Nr. 4/2018 të Punës së Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës.

KAPITULLI I V

Neni 17

Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. 01/2018 për procedurat hetimore të AKK-së. Në rast të vështirësisë së aplikimit të dispozitave të kësaj rregulloreje, apo mungesa e dispozitave përmarrjen e vendimit përfundimtar, aplikohen dispozitat e Ligjit për

Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe ligjet e tjera që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të konkurrencës.

Neni 18
Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores

Ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit, i/e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me nënshkrimin nga Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës dhe publikimin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

22.03.2023

Kryetare

Neime Binaku - Isufi

